



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2019:281561

Datë: 13.08.2024

Numri i dokumentit: 06046535

**2023:234992**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK-** Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.32/24 të datës 09.08.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit K. Snga Ferizaj, dhe të dëmtuarit A.L nga fsh. ...-Kaçanik, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.2101/19 të datës 27.11.2019, për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 181 par.2 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, më datën 13.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** Marrëveshja e Ndërmjetësimit Nd.nr.32/24 e datës 09.08.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit, K.S.nga Ferizaj dhe të dëmtuarit A.L nga fsh...- Kaçanik.

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.2101-10/19 e datës 27.11.2019, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit K. (R...) S nga Ferizaj, Rr.”...” nr..., i lindur me datë ...me nr.personal: ..., për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka parashtruar pranë kësaj gjykate aktakuzën, PP/II.nr.2101-10/19 e datës 27.11.2019, kundër të pandehurit K. S nga Ferizaj, për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së .

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 08.08.2024, palët në procedurë, dhe ate i pandehuri K. S dhe i dëmtuari A.L, janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si 2023:234992 , të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që lënda të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datë 09.08.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit te kësaj gjykate, është arritur Marrëveshja Ndërmjetësimit, Nd.nr.32/24, në mes palëve në procedurë dhe ate të pandehurit K. S dhe të dëmtuarit A.L.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**2023:234992 datë, 13.08.2024**

Sekretarja Juridike  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.